



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS
RREGULLORE**

**“PËR
LICENCIMIN, ORGANIZIMIN, VEPRIMTARINË DHE MBIKËQYRJEN E ZYRAVE TË
KËMBIMIT VALUTOR”**

Miraturar me vendimin nr. 31, datë 06.06.2007, ndryshuar me vendimin nr. 73, datë 27.11.2007, me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011, me vendimin nr. 31, datë 30.04.2014 dhe me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

**Kreu I
Të përgjithshme**

**Neni 1
Objkti**

Objkti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve dhe i rregullave për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12 shkronja “b”, nenit 43, shkronja “c” dhe nenit 61, shkronja “b” të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b) nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

**Neni 3
Përkufizime**

Për efekt të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë të njëjtin kuptim si në nenin 4 të ligjit “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) **“valutë”** - janë mjetet financiare në formën e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike të huaja, të cilat kanë kurs ligjor.

- b) **“veprimtari e këmbimit valutor”** - është veprimtaria e shitblerjes së valutave në para fizike dhe të çeqeve të udhëtarëve ushtruar nga zyra e këmbimit valutor në emër dhe për llogari të saj, në mënyrë të vazhdueshme dhe për qëllime fitimi.
- c) **“subjekt”** - është personi juridik, i cili aplikon dhe licençohet si zyrë e këmbimit valutor sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
- d) **“zyra”** - është ambjenti në të cilin ushtrohet veprimtaria e këmbimit valutor.
- e) **“të dhëna identifikuese”** për një subjekt janë:
1. emri i tij tregtar;
 2. numri identifikues (kodi fiskal),
 3. adresa e selisë ¹dhe adresa e zyrave ku ushtron veprimtarinë/të, përfshirë dhe adresën/at elektronike;
 4. objekti i veprimtarisë së tij tregtare të përcaktuar në certifikatën e regjistrimit të subjektit²;
 5. emrat e kambistëve;
 6. emri, mbiemri dhe nënshkrimi i administratorit të kësaj zyre; si dhe
 7. ³emrat e aksionerëve ose ortakëve të zyrës.
- f) **“faturë”** - është dokumenti i lëshuar nga zyra e këmbimit valutor për çdo transaksion këmbimi, i cili përmban:
1. llojin e monedhës;
 2. shumën dhe kursin e këmbimit;
 3. vlerën e këmbyer;
 4. komisionin ⁴nëse aplikohet;
 5. emrin, adresën dhe kodin fiskal të zyrës; si dhe
 6. numrin rendor të dokumentit.
- g) **“bilanci në valutë”** - është dokumenti në të cilin hidhen të dhënat ditore për të gjitha transaksionet e kryera, sipas informacionit të dhënë në faturë.
- i) **“kurs këmbimi”** - është çmimi relativ i një monedhe të shprehur në njësi të një monedhe tjetër, në një datë të caktuar.
- j) shfuqizuar.⁵
- k) **“kambist”** - është individ i autorizuar nga Banka e Shqipërisë për të kryer veprimtarinë e këmbimit valutor në emër dhe për llogari të zyrës së këmbimit valutor, në ambientet e zyrës.
- l) **“Banka”** – është Banka e Shqipërisë.

Neni 4

Licencimi i veprimtarisë së këmbimit valutor

Subjekti licençohet nga Banka në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, për të ushtruar veprimtarinë e këmbimit valutor.

¹ Ndryshuar me vendimin Nr. 31, datë 31.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

² Ndryshuar me vendimin Nr. 73, datë 27.11.2007 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³ Shtuar me vendimin Nr. 31, datë 31.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴ Shtuar me vendimin Nr. 31, datë 31.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁵ Ndryshuar me vendimin Nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 5⁶
Shfuqizuar

Kreu II
Licencimi i subjektit⁷

Neni 6⁸
Dokumentacioni për licencim

1. Kërkesa për licencim bëhet me shkrim nga administratori i subjektit ose personi i autorizuar ligjërisht prej tij dhe shoqërohet me të dhënat identifikuese, të përcaktuara në aneksin 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje, si dhe me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Ekstraktin e regjistrimit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, për regjistrimin e subjektit si person juridik, në të cilin të jetë shprehur si objekt i veprimtarisë së shoqërisë, veprimtaria financiare e këmbimeve valutore⁹.
 - b) Vërtetime të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit territorial për aksionarët ose ortakët, administratorin dhe kambistët, të cilat vërtetojnë faktet e mëposhtme juridike:
 - i. vërtetim se personi nuk është në ndjekje penale;
 - ii. vërtetim se personi nuk është në gjykim për vepra penale;
 - iii. vërtetim nga Ministria e Drejtësisë se personi nuk është i dënuar penalisht ose formularin e vetëdeklarimit, sipas aneksit nr. 4 të kësaj rregulloreje¹⁰;
 - iv. vërtetim nga Zyra e Përmbartimit Gjyqësor se personi nuk ka detyrime pasurore të pashlyera.Dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë lëshuar jo më larg se 3 (tre) muaj nga dita e paraqitjes së aplikimit për licencë.
 - c) Kopje të legalizuar të dokumentit identifikues të administratorit/ve, aksionerëve ose ortakëve dhe kambistëve.
 - d) Dokumentin që vërteton pronësinë ose marrjen me qira të lokaleve ku do të ushtrohet veprimtaria e këmbimit valutator.
 - e) 2 (dy) fotografi për çdo kambist të subjektit, të cilat përdoren nga Banka për përgatitjen e kartave të identifikimit të tyre.
 - f) Dokumentin vërtetues mbi nivelin e arsimimit të administratorit (të paktën arsimin e mesëm).
 - g) Vërtetim nga banka ose dega e bankës së huaj të licencuar nga Banka, që subjekti ka bllokuar shumën e kapitalit të kërkuar sipas nenit 8, pika 1 në një llogari pranë saj. Kjo shumë, zhblokohet nëpërmjet njoftimit të Bankës, në përfundim të procedurës së licencimit.

⁶ Shfuqizuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁷ Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁸ Shkronja "f" bëhet "g", pasi shkronja "g" e këtij neni të rregullores është shfuqizuar sipas ndryshimit të përcaktuar në vendimin nr. 73, datë 27.11.2007 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁹ Ndryshuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁰ Ndryshuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- h) deklaratën e nënshkruar nga administratori i personit juridik, sipas aneksit nr. 5 të kësaj rregulloreje, mbi njohjen dhe zbatueshmërinë e detyrimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor¹¹;
- i) Informacion mbi pajisjet e nevojshme teknike/administrative që zyra disponon për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor, siç listohen në aneksin nr. 6, bashkëngjitur dhe pjesë e kësaj rregulloreje¹²;
- j) Informacion mbi mjediset dhe kushtet e sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor, në zbatim të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për këtë qëllim. Dokumenti i kërkuar sipas kësaj shkronje, duhet të përmbajë të paktën informacion për mjediset dhe kushtet e sigurisë të përcaktuara në aneksin nr.7 bashkëlidhur kësaj rregulloreje¹³.

2. Dokumentacioni sipas pikës 1 këtij neni duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të legalizuar. Ai dorëzohet në Bankë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 7¹⁴ Shfuqizuar

Neni 8 Kërkesa për kapitalin

1. Kapitali fillestar minimal i kërkuar për t'u licencuar nga Banka për të kryer veprimtarinë e këmbimit valutor, është 1,500,000 lekë ose kundërvlera e tij në dollarë amerikanë (usd) ose në monedhën europiane, euro.
2. Shfuqizuar.¹⁵
3. ¹⁶Kapitali i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, derdhet në një llogari bankare, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e derdhjes.

Neni 9 Shqyrtimi i kërkesës për licencim

1. Banka, në rast se konstaton që kërkesa për licencim dhe dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti nuk janë të plota në përputhje me kërkesat e nenit 6 të kësaj rregulloreje, njofton subjektin brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga marrja e këtij dokumentacioni, për nevojën e plotësimit të mëtejshëm të tij.
2. Subjekti duhet të paraqesë të dhënat dhe/ose dokumentacionin e kërkuar nga Banka¹⁷ brenda 14 (katërmëdhjetë) ditë pune nga dërgimi i njoftimit, sipas pikës 1 të këtij neni.

¹¹ Ndryshuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹² Ndryshuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹³ Ndryshuar me vendimin nr. 31, datë 31.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁴ Shfuqizuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁵ Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁶ Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁷ Ndryshuar me vendimin nr. 73, datë 27.11.2007 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

3. Banka ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për licencë, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga subjekti brenda 3 (tre) muajve pas datës së aplikimit fillestar për licencë, sipas pikës 1 të këtij neni dhe njofton subjektin për sa më sipër.
4. ¹⁸ Pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë, sipas kërkesave të parashikuara në nenin 6¹⁹, Banka inspekton zyrën/zyrat ku është parashikuar të zhvillohet veprimtaria e këmbimit valutor, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve të sigurisë për kryerjen e kësaj veprimtarie, në zbatim të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka për këtë qëllim.

Neni 10 Licenca

1. Banka jep ose refuzon dhënien e licencës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike pas plotësimit të kërkesave të parashikuara në nenin 6²⁰, nenin 8 dhe nenin 9, pika 4 të kësaj rregulloreje.
2. Banka, brenda 3 (tre) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit sipas pikës 1 të këtij neni, i dorëzon subjektit licencën ose e njofton atë me shkrim mbi refuzimin e dhënies së saj, duke shpjeguar arsyet përkatëse.
3. Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.
4. Subjekti mund të ushtrojë veprimtarinë e tij në një²¹ ose me shumë zyra, për të cilat Banka lëshon një licencë të vetme.
5. Licenca përfshin emrin tregtar të subjektit, numrin dhe datën e lëshimit të saj.
6. Licenca shoqërohet me kartën e identitetit për çdo kambist të subjektit, që autorizon kryerjen e veprimtarisë së këmbimit valutor, në emër dhe për llogari të këtij subjekti.

Neni 11²² Shfuqizuar

Neni 12 Komisionet

Subjekti për të ushtruar veprimtarinë e këmbimit valutor, paguan në Bankë komisionet si më poshtë:

- a) për dhënien e licencës shumë prej 1.500 (një mijë e pesë qind) lekësh; dhe
- b) për çdo kartë identifikimi të kambistëve shumë prej 500 (pesë qind) lekësh.

¹⁸ Ndryshuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁹ Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁰ Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²¹ Ndryshuar me vendimin nr. 73, datë 27.11.2007 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²² Shfuqizuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Kreu III
Organizimi dhe veprimtaria e zyrave të këmbimit valutor

Neni 13
Organizimi

Subjekti krijohet dhe funksionon si shoqëri tregtare në bazë të ligjit “Për shoqëritë tregtare”.

Neni 14
Veprimtaria e këmbimit valutor²³

1. Veprimtaria e këmbimit valutor në zyrë ushtrohet vetëm nga kambistët e autorizuar, të cilët identifikohen nga karta përkatëse e lëshuar nga Banka.
2. Subjekti, kryen në emër dhe për llogari të vet, veprimtarinë e këmbimit valutor si më poshtë:
 - a) shitjen/blerjen e valutave;
 - b) shitjen/ blerjen e çeqeve të udhëtarëve.
3. Shfuqizuar.²⁴
4. Shfuqizuar.²⁵

Neni 15
Kërkesat gjatë ushtrimit të veprimtarisë

1. Subjekti i licencuar për ushtrimin e veprimtarive të përcaktuara në nenin 14 të kësaj rregulloreje:
 - a) organizon dhe mban kontabilitetin, në formën e përcaktuar nga ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
 - b) mban libra arke për çdo monedhë;
 - c) mban bilancin valutor; si dhe
 - d) llogarit pozicionin e hapur nga këmbimet valutore, në fund të çdo dite.
2. Informacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ruhet sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Neni 16
Transparenca

Subjekti, gjatë ushtrimit të veprimtarive të përcaktuara në nenin 14, ruan transparencën ndaj klientit duke:

²³ Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁴ Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁵ Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- a) afishuar në një vend të dukshëm në zyrën/zyrat e tij licencën e marrë nga Banka;
- b) afishuar në një vend të dukshëm në zyrën/zyrat e tij, kurset e këmbimit ²⁶dhe komisionet (nëse aplikohen) që përdor për veprimtarinë e këmbimit valutor;
- c) shfuqizuar.²⁷
- d) pajisur klientin me faturë për çdo transaksion këmbimi valutor si dhe duke ruajtur një kopje të saj²⁸.
- e) informuar klientin përpara kryerjes së transaksionit, në rast të aplikimit të komisioneve, nëpërmjet “Deklaratës për njohjen paraprake me komisionin e aplikuar”, të përcaktuar në aneksin nr.8 bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Subjekti e ruan deklaratën, jo më pak se një muaj pas nënshkrimit të saj nga klienti²⁹.

Neni 17

Parandalimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit

1. ³⁰Subjekti gjatë ushtrimit të veprimtarive të përcaktuara në këtë rregullore, vepron në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, veçanërisht në lidhje me:
 - a) identifikimin e klientit sipas dokumentacionit të kërkuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;³¹
 - b) ruajtjen e të dhënave mbi klientin dhe mbi transaksionet e kryera, sipas afateve të kërkuara;
 - c) raportimin pranë autoriteteve përkatëse, për transaksionet e dyshimta dhe për transaksionet vlera e të cilave tejkalon kufirin e përcaktuar nga ligji “Për parandalimin e pastrimit të parave”.

Kreu V

Mbikëqyrja

Neni 18

Ushtrimi i mbikëqyrjes

1. Banka, realizon procesin e mbikëqyrjes së veprimtarisë së subjekteve të licencuara sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, nëpërmjet:
 - a) inspektimeve në vend;
 - b) mbledhjes së të dhënave financiare për veprimtaritë që ushtrojnë subjektet;
 - c) zbatimit të masave ndëshkimore, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Inspektimet në vend sipas pikës 1, shkronja a) të këtij neni realizohen për të vlerësuar përputhshmërinë e veprimtarisë së ushtruar nga subjekti me dispozitat

²⁶ Shtuar me vendimin nr. 31, datë 31.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁷ Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁸ Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁹ Shtuar me vendimin nr. 31, datë 31.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁰ Ndryshuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³¹ Ndryshuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me dispozitat e kësaj rregulloreje në fazën e licencimit, të ushtrimit të veprimtarisë deri në revokimin e licencës së saj.

Në fund të çdo inspektimi, hartohet raporti i inspektimit nga Departamenti i Mbikëqyrjes, i cili i dërgohet subjektit, së bashku me rekomandimet dhe/ose masat ndëshkimore të propozuara.

3. Mbledhja e të dhënave financiare për veprimtarinë që ushtron subjekti, organizohet ipas nevojave të Bankës së Shqipërisë.
4. Për shkeljet e konstatuara, të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi nga subjekti, anka zbaton masat ndëshkimore të përcaktuara në dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 19 Raportimet

1. Subjekti raporton pranë Departamentit të Operacioneve Monetare në Bankë për transaksionet e këmbimit valutor të kryera çdo ditë, për vëllimin e blerjeve dhe të shitjeve të valutave, si edhe për kursin mesatar të këmbimit për çdo monedhë, sipas aneksit 2 dhe aneksit 3 të kësaj rregulloreje.
2. Subjekti raporton çdo ditë në Departamentin e Operacioneve Monetare në përputhje me pikën 1 të këtij neni sipas aneksit 2 bashkëlidhur.
3. Subjekti raporton mbi baza javore, çdo të premtë, vetëm pozicionet në lekë sipas aneksit 3 bashkëlidhur.
4. Subjektet, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në dy ose me shumë zyra, mbledhin informacionin nga secila prej tyre dhe raportojnë në Bankë mbi baza të konsoliduara.
5. Raportimet nga ana e subjektit në Bankë sipas këtij neni, bëhen në rrugë elektronike, me faks ose me postë.

Neni 20 Masat ndëshkimore

1. Banka kur konstaton se subjekti është në shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, merr masa ndëshkimore sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
2. Banka gjobit subjektin dhe/ose administratorin e saj, në masën 20,000 (njëzet mijë) lekë deri në 100,000 (një qind mijë) lekë, kur konstaton se:
 - a) subjekti nuk zbaton dispozitat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
 - b) punonjësit e subjektit nuk janë autorizuar si kambistë nga Banka;
 - c) subjekti nuk afishon licencën për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor³²;
 - d) kambistët e subjektit nuk lëshojnë faturën përkatëse për transaksionet e këmbimit valutor³³;
 - e) subjekti nuk plotëson kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë lidhur me kushtet teknike dhe të sigurisë, në përputhje me aktet nënligjore të Bankës;
 - f) subjekti nuk vepron në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit;
 - g) subjekti nuk raporton në Bankë, në përputhje me kërkesat e nenit 19 të kësaj rregulloreje;

³² Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³³ Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- h) subjekti pa dijeninë e Bankës ka ndryshuar të dhënat e tij mbi bazën e të cilave ai është licencuar nga Banka, dhe nuk ka njoftuar Bankën e Shqipërisë për këto ndryshime;
- i) subjekti nuk informon klientin nëpërmjet “Deklaratës për njohjen paraprake me komisionin e aplikuar”, sipas shkronjës “e” të nenit 16 të kësaj rregulloreje³⁴;
- j) kambisti ushtron veprimtarinë e këmbimit valutor jashtë ambienteve të zyrës së këmbimit valutor³⁵.

3. Gjobat e përcaktuara sipas pikës 2 të këtij neni paguhen për llogari të Bankës.

Neni 21 Pezullimi dhe revokimi i licencës

1. Banka pezullon licencën e subjektit për 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike, në rast se ka prova të besueshme që subjekti është përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
2. Banka revokon licencën e subjektit, në rast se ky i fundit :
 - a) në mënyrë të përsëritur, kryen shkeljet e parashikuara në nenin 20, pika 2 të kësaj rregulloreje;
 - b) është përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
 - c) ka paraqitur dokumentacion të falsifikuar gjatë procedurës së aplikimit për licencë³⁶;
 - d) ka humbur kushtet në bazë të të cilave ai është licencuar;
 - e) ushtron veprimtari financiare të tjera pa licencën e Bankës së Shqipërisë³⁷;
 - f) nuk paguan gjobën e vendosur nga Banka sipas pikës 2 të nenit 20, të kësaj rregulloreje;
 - g) nuk fillon veprimtarinë brenda 45 (dyzetepesë) ditëve kalendarike nga marrja e licencës;
 - h) ndërpret veprimtarinë për më tepër se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike;
 - i) ndërpret veprimtarinë me iniciativën e tij.
3. Në rastin e revokimit të licencës, subjekti dorëzon në Bankë licencën dhe kartat identifikuese të kambistëve.

Neni 22 Procedura për vendosjen e masave ndëshkimore

1. Në çdo rast të vendosjes së masave ndëshkimore dhe të revokimit të licencës, Banka njofton subjektin si dhe personat përgjegjës për masën ndëshkimore të dhënë dhe/ose revokimin e licencës brenda 3 (tre) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit të saj për këto masa.
2. Banka, para nxjerrjes së aktit administrativ për marrjen e masës ndëshkimore të parashikuar në nenet 20 dhe 21 të kësaj rregulloreje, i jep subjektit ndaj të cilit

³⁴ Shtuar me vendimin nr. 31, datë 31.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁵ Shtuar me vendimin nr. 31, datë 31.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁶ Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁷ Ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

propozohet vendosja e masës ndëshkimore, të drejtën për të paraqitur mendimet e tij me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve.

Neni 23 **E drejta e ankimit**

Subjekti ka të drejtën e ankimit ndaj çdo akti administrativ të Bankës, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në nenin 93, të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 24 **Detyrimi për njoftim**

Subjekti gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij njofton Bankën:

- a. Menjëherë, kur ka ndryshime të kambistëve dhe kërkon pajisjen e kambistëve të rinj me karta identifikimi, pas dorëzimit në Bankë të kartave të identifikimit të kambistëve të larguar;
- b. brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditëve kalendarike, për çdo ndryshim në të dhënat identifikuese, të përcaktuara në nenin 3, shkronja “e”³⁸ si dhe dokumentacionin e subjektit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, ³⁹të kësaj rregulloreje.

Kreu VI

Neni 25⁴⁰ **Dispozitë kalimtare**

1. Subjektet e licencuara nga Banka përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, konsiderohen të licencuara në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje. Banka ka të drejtë t’i kërkojë subjekteve të licencuara, informacione shtesë nëse sipas opinionit të saj, informacioni i paraqitur në kohën e marrjes së licencës nuk është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Neni 26 **Të fundit**

1. Rregullorja “Për licencimin e zyrave të këmbimit valutor” e miratuar me vendimin nr. 65, datë 30.07.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.
2. Rregullorja “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor” hyn në fuqi me publikimin e saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI

³⁸ Ndryshuar me vendimin nr. 73, datë 27.11.2007 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁹ Ndryshuar me vendimin nr. 31, datë 31.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴⁰ Ndryshuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

ANEKSI 1

A P L I K I M

Për licencë për Zyrë Këmbimi Valutor

1. Emri i plotë i personit ose shoqërisë që aplikon për licencë.

2. Selia e shoqërisë.

3. Personi/Personat që përfaqësojnë Zyrën e Këmbimit Valutor sipas regjistrimit në Gjykatë.
Z/Znj. _____
Z/Znj. _____ etj.
4. Emri i Zyrës së Këmbimit Valutor.

5. Kodi i identifikimit në regjistrin tatimor.(Kodi fiskal/NIPT-i).

6. Llogari bankare të hapura në banka në Shqipëri.
 1. _____ (emri i bankës; monedha, numri i llogarisë)
 2. _____ (emri i bankës; monedha, numri i llogarisë) etj.
7. Adresa e plotë e vendit ku kërkohet të ushtrohet veprimtaria e Zyrës së Këmbimit.

8. Numri i telefonit, i faksit për Zyrën e Këmbimit Valutor dhe personat e kontaktit.

9. Emrat e personit/ave që do të ushtrojnë veprimtarinë e këmbimit valutor.
Z/Znj. _____
Z/Znj. _____ etj.
10. Adresën/at elektronike të zyrës së këmbimit valutor⁴¹.
DATA: _____

APLIKANTI: _____
(emër, mbiemër, firmë, vulë)

⁴¹ Shtuar me vendimin nr. 31, datë 31.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

ANEKSI NR. 2

RAPORTIMI DITOR I VEPRIMTARISË SË KËMBIMIT VALUTOR					
ZYRA E KËMBIMIT VALUTOR					
KËMBIMI I VALUTAVE KUNDREJT LEKUT					
	[1]	[2]	[3]	[4]	[5]
MONEDHA	BLERJE	KURSI MESATAR	SHITJE	KURSI MESATAR	POZICIONI (në lekë)
EUR					[1]x[2] - [3]x[4]
USD					
GBP					
CHF					
CAD					
AUD					
....					
					TOTALI I POZICIONIT (në leke; shuma e kolonës [5])
Detajim i detyrueshëm:	Veprime me:	Blerje valute (në lekë)	Shitje valute (në lekë)		
	Banka				
	Zyra të këmbimit valutor				
	Biznese				
	Individë				

Shënim: Kursi mesatar i këmbimit, llogaritet si më poshtë:

$$(2) \text{ KMKblerje} = (VB1 * KBblerje1 + VB2 * KBblerje2 ++VBn * KBblerjen) / (VB 1+ VB 2+....+ VB n)$$

$$(4) \text{ KMKshitje} = (VS1 * KSshitje1 + VS2 * KSshitje2 ++VSn * KSshitjen) / (VS 1+ VS 2+....+ VS n)$$

- KMKblerje (KMK shitje) - përcakton kursin mesatar të këmbimit për transaksionet në blerje (shitje); VBi (VSi) - përcakton vlerën e transaksionit i në blerje (shitje)
- KB blerje (KS shitje) -përcakton kursin e këmbimit për transaksionin në blerje (shitje).

KEMBIMI I VALUTAVE KUNDREJT VALUTAVE		
	[1]	[2]
MONEDHA	BLERJE	SHITJE
EUR		
USD		
GBP		
CHF		
CAD		
AUD		
.....		

ANEKSI NR. 3

**RAPORTIMI JAVOR* I VEPRIMTARISË SË KËMBIMIT VALUTOR
ZYRA E KËMBIMIT VALUTOR _____ (Emri i zyrës)**

POZICIONI I KUMULIMIT (në lek; nga fillimi i vitit)	SHUMA E PAGESAVE (në lek) E TOTALIT TË POZICIONIT DITOR (Kolona 5 e raportimit ditor të këmbimit valutor)
---	---

Bëhet çdo ditë të premte

ANEKSI NR. 4⁴²

FORMULAR VETËDEKLARIMI

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 9614, datë 21.09.2006 "Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore"

Të dhënat e vetë-deklaruesit:

Mbiemri, Emri	
Atësia/Amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: i/e padënuar i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

Emër Mbiemër/ Firmë

Emër Mbiemër/ Firmë/ Vulë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga BANKA E SHQIPËRISË.

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit

Shënim:

- Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517, datë 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

⁴² Shtuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

ANEKS NR. 5⁴³

**DEKLARATË PERSONALE MBI USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË KËMBIMIT
VALUTOR**

ADMINISTRATORI

SHOQËRIA _____ SH.P.K / SH.A

Nëpërmjet kësaj deklarate synohet rritja e mëtejshme e përgjegjshmërisë së administratorëve në ushtrimin e funksioneve të tyre, në përputhje të plotë me detyrimet ligjore dhe/ose nënligjore, për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor.

Unë, i/e nënshkruari/a _____, identifikuar nëpërmjet (lloji i mjetit të identifikimit) _____ nr. _____ dhe me datë lëshimi _____, lindur në qytetin e _____ dhe me banim në (adresa) _____, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, si dhe në rolin e administratorit të shoqërisë “ _____ ” sh.p.k/sh.a, me seli (adresa) _____, deklaroj nën përgjegjësinë dhe vullnetin tim të lirë se jam i ndërgjegjshëm dhe njohës i përgjegjësive, kërkesave dhe detyrimeve të kuadrit ligjor dhe/ose nënligjor që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor në Republikën e Shqipërisë, dhe në veçanti të kërkesave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi, por pa u kufizuar vetëm në:

- Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, të cilat mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (www.fint.gov.al);
- Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”; rregulloren “Për licencimin, organizmin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendim nr. 31, datë 06.06.2007, e ndryshuar; rregulloren “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendim nr. 04, datë 10.01.2011; rregulloren “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendim nr. 44, datë 10.06.2009, të cilat mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë (www.bankofalbania.org).

Me respekt,

Z/Znj. _____
Administrator/e i/e Shoqërisë “ _____ ” Sh.p.k/Sh.a

(nënshkrim/firmë, vulë)

⁴³ Shtuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

ANEKS NR. 6⁴⁴

INFORMACION MBI PAJISJET TEKNIKO-ADMINISTRATIVE⁴⁵

Zyra e këmbimit valutor, e vendosur në adresën....., ka krijuar kushtet tekniko-administrative për realizimin e aktivitetit të këmbimit valutor.

Pajisjet tekniko-administrative, që disponon zyra për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lloji i pajisjes	Disponueshmëria e pajisjes
• Kompjuter, printer dhe/ose aksesoret e tyre	√
• Fotokopje dhe/ose skaner	√
• Mjete komunikimi (telefon dhe/ose faks, e-mail)	√
• Makinë të numërimit dhe të verifikimit të parave	√
• Tabelë e shfaqjes për publikun të kursit të këmbimit dhe të komisioneve (nëse aplikohen)	√
• Faturë tip për veprimet në sportel	√
• Tabelë e jashtme e shoqëruar me emërtimin ligjor të zyrës	√

Informacioni i kërkuar sipas nenit 6, pika 1, shkronja "i" të kësaj rregulloreje, mund të shtohet edhe për pajisjet shtesë që zyra disponon, të cilat e ndihmojnë (zyrën) në ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor dhe/ose të veprimtarisë së shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, në rastet e parashikuara dhe të lejuara nga kjo rregullore.

Datë _____

Me respekt,

Z/Znj. _____

Administrator/e i/e Shoqërisë " _____ " Sh.p.k/Sh.a

(nënshkrim/firmë, vulë)

⁴⁴ Shtuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴⁵ Ndryshuar me vendimin nr. 31, datë 31.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

ANEKS NR. 7⁴⁶

INFORMACION MBI MJEDISËT DHE KUSHTET E SIGURISË

Zyra e këmbimit valutor, e vendosur në adresën....., ka krijuar kushtet e sigurisë për realizimin e aktivitetit të këmbimit valutor, siç paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Kushtet	Disponueshmëria
• Zyra ka hapësira të nevojshme dhe kushte të përshtatshme për mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe vlerave monetare	√
• Zyra ka qartësisht të ndarë zonën e pritjes së klientit nga zona e arkëtarëve	√
• Zona e arkëtarëve kufizohet nga zonat e tjera me sportel	√
• Vlerat monetare mbahen në kasafortë	√
• Zyra monitorohet me telekamera	√
• Telekamerat filmojnë në mënyrë të pandërprerë	√
• Zyra ka pajisje dixhitale për regjistrimin e pamjeve	√

Informacioni i kërkuar sipas nenit 6, pika 1, shkronja "j" të kësaj rregulloreje, mund të shtohet edhe për pajisjet shtesë që zyra disponon, të cilat e ndihmojnë (zyrën) në ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor dhe/ose të veprimtarisë së shërbimeve të pagesave dhe transferimit të parave, në rastet e parashikuara dhe të lejuara nga kjo rregullore.

Datë _____

Me respekt,

Z/Znj. _____

Administrator/e i/e Shoqërisë _____

(nënshkrim, vula⁴⁷)

⁴⁶ Shtuar me vendimin nr. 31, datë 31.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴⁷ Shtuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

ANEKS NR. 8⁴⁸

DEKLARATË PËR NJOHJEN PARAPRAKE ME KOMISIONIN E APLIKUAR

Deklaroj se u informova paraprakisht mbi aplikimin e komisionit në transaksionin e mëposhtëm:

Transaksioni: Këmbim nga _____ në _____
(monedha) (monedha)

Kursi i këmbimit	_____
Shuma për t'u këmbyer	_____
Shuma pas konvertimit	_____
Komisioni që mbahet (%)	_____
Komisioni që mbahet (në vlerë)	_____
SHUMA FINALE që përfiton klienti	_____

Data e kryerjes së transaksionit _____

Nënshkrimi i klientit

(emër, mbiemër, firmë)

⁴⁸ Shtuar me vendimin nr. 31, datë 31.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.